



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit nr.03/L-15 për qasje në dokumente publike i datës 07 tetor 2010, Udhëzimit Administrativ nr.05/2013 për transparencë në Komuna si dhe neneve 20, 63, 64 dhe 65 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e datës 27.06.2014, miratoi këtë

RREGULLORE PËR TRANSPARENÇË

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i miratimit të Rregullores (në vazhdim të tekstit Rregullorja) është implementimi në praktikë i dispozitave të cilat përcaktojnë obligimet e Komunës mbi transparencën.

Neni 2

Fushëveprimi

Me këtë rregullore, përcaktohet forma e njoftimit të qytetarëve të Komunës për punën e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të tij dhe organeve të administratës komunale, organizimi i takimeve me publikun, organizimi i konsultimeve publike për draftet e akteve për miratim në Kuvendin e Komunës si dhe krijimin e kushteve për qasjen në dokumente publike të Komunës.

Neni 3

Njoftimi i publikut për punën e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të tij

1 Publiku do të njoftohet për mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të tij nëpërmjet :

- a) Ueb faqes zyrtare të Komunës dhe
- b) Medieve të shkruara dhe elektronike lokale.
- c) Tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës

2. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës ose Komitetit përkatës, nëpërmes Zyrës së Kryetarit – Sektorit për marrëdhënie me publikun, njofton publikun së paku shtatë (7) ditë pune para mbledhjeve të rregullta ose (3) tre ditë pune para mbledhjeve të jashtëzakonshme përmes:

- a) Ueb faqes zyrtare të Komunës;
- b) Medieve të shkruara dhe elektronike lokale;

3. Njoftimi publik duhet të përmbajë:

- a) Datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes;
- b) Rendin e ditës .

Neni 4

Pjesëmarrja e publikut në punën e Kuvendit dhe Komiteteve të tij

1. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij janë të hapura për publikun dhe përfaqësuesit e mjeteve të informimit.
2. Mbledhjet e Kuvendit Komunës dhe komiteteve të tij mund të jenë të mbyllura pjesërisht ose tërësisht në rastet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi .
3. Kuvendi i Komunës ose Komitetet përkatëse vendosin që mbledhja për çështjen e caktuar të mos jetë e hapur për publikun.
4. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës ose Komitetit përkatës siguron hapësirën përkatësisht vendet e caktuara për pjesëmarrjen e publikut;
5. Para mbajtjes së mbledhjes publiku mund të paiset në Sektorin për punë të Kuvendit ose në Sektorin për marrëdhënie me publikun me materialet që janë për shqyrtim publik sipas rendit të ditës.

Neni 5

Publikimi i akteve

1. Të gjitha vendimet, rregulloret dhe dokumentet tjera të miratuara nga Kuvendi i Komunës, publikimi i të cilave nuk kufizohet sipas Ligjit për qasje në dokumente publike, publikohen në :

- a) Ueb faqes zyrtare të Komunës dhe
- b) Tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

2. Në dokumentet publike të miratuara nga Kuvendi për të cilat nuk kufizohet qasja sipas Ligjit për qasje në dokumente publike, publiku mund të ketë qasje një javë pas mbajtjes së mbledhjes.

Neni 6 Takimet me publikun

1. Çdo vit komuna mban së paku dy takime me publikun për çështje të interesit të përgjithshëm, në të cilën mund të marr pjesë secili person apo organizatë me interes në Komunë.

2. Njëri nga takimet mbahet në (6) gjashtë mujorin e parë të vitit.

3. Përveq dy takimeve të detyrueshme me publikun, Komuna mund të mbaj edhe mbledhje shtesë për çështje të ndryshme me interes të përgjithshëm.

4. Komuna siguron hapësirat e mjaftueshme brenda territorit të Komunës për pjesëmarrje më të gjerë dhe aktive të publikut,

5. Komuna përmes Zyrës së Kryetarit - Sektorit për marrëdhënie me publikun, njofton qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit publik dhe njoftimi bëhet në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës si dhe përmes:

a) Shpalljeve publike

b) Mediave të shkruara dhe elektronike lokale

c) Ueb- faqes zyrtare të komunës;

6. Njoftimi i publikut sipas paragrafit 6.5 të këtij neni duhet të përmbajë :

a) Datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së takimit

b) Rendin e ditës

Neni 7 Konsultimi i publikut para miratimit të akteve

Organet e Komunës në pajtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës dhe Udhëzimin administrativ nr.05/2013 për transparencë në Komuna do të ndërmarrin masat që të organizohet konsultimi publik në procedurën e miratimit të rregulloreve dhe akteve nga kompetenca e Komunës.

Neni 8 Kërkesa për informim

1. Çdo subjekt fizik ose juridik i interesuar ka të drejtë të parashtroi kërkesë për informacion për veprimtarinë e Komunës .

2.Lidhur me kërkesat për informim, Organet e Administratës Komunale nga fushëveprimtaria e vet kanë për obligim që tu përgjigjen palëve në afat prej 30 dite nga dita e parashtrimit të kërkesës.

Neni 9 Peticioni

1. Në pajtim me dispozitat e nenit 69 të Ligjit për vetëqeverisje lokale çdo person apo organizatë me interes në komunë ka të drejtën e prezentimit të petitionit në Kuvendin e Komunës për çfarëdo çështje lidhur me përgjegjësitë dhe kompetencat e Komunës .
2. Kuvendi i Komunës shqyrton petitionin brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh në pajtim me Statutin dhe Rregulloren e punës.

Neni 10 Qasja në dokumente publike

1. Në përputhje me Ligjin Nr.03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, organet e administratës komunale u garantojnë qasje në informata respektivisht në dokumente publike, personave fizik dhe juridik.
2. Njësia/zyrtari përgjegjës për komunikim me qytetarët bën pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente publike të aprovuar nga organet e Komunës të cilat mund të parashtrohen në formë të shkruar apo elektronike dhe i adreson në pajtueshmëri me Ligjin Nr.03/L-215 për qasje në dokumente publike.
3. Nëse organet e komunës nuk e posedojnë dokumentin e kërkuar nga parashtruesi i kërkesës, atëherë organet e komunës detyrohen që në afat prej (5) pesë dite pune nga dita e pranimit të kërkesës me shkrim, t'a përcjellë dokumentin në organin gjegjës i cili e posedon informatën.
4. Organet e komunës obligohen që brenda afatit prej shtatë (7) ditëve nga dita e marrjes së kërkesës të nxjerrin vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të japin përgjegje me shkrim për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesërishëm dhe informon kërkuuesin për të drejtën që ai ka për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim.
5. Në rast të refuzimit të kërkesës të plotë apo të pjesërishëm, parashtruesi i kërkesës mundet që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas marrjes së përgjigjes nga organet e komunës, të parashtroj kërkesën për rishqyrtimin e çështjes duke kërkuar nga organet e komunës që ta rishqyrtoj vendimin.
6. Afati për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike mund të vazhdohet deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë, në qoftë se dokumenti kërkohet jashtë

organeve të komunës, dhe nëse përmes një kërkesë kërkojnë disa dokumente publike.

Neni 11
Zbatimi i Rregullores

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdeset Drejtorati për Administratë dhe Zyra e Kryetarit të Komunës- Sektori për marrëdhënie me publikun.

Neni 12
Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi 8 (tetë) ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës dhe në Tabelën e Shpalljeve të Kuvendit të Komunës.
2. Me miratimin e kësaj Rregullorej shfuqizohet Rregullorja për transparencën e 1Nr. 020-252 e datës 20.03.2009.

Nr. 15-011-24892
Lipjan, më 30.06.2014

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

KRYESUESI I KUVENDIT
Vlora Limani-Hajnuni

